



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2021:145619

Datë: 20.05.2024

Numri i dokumentit: 05710025

KPPP.nr.2154/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Arnis Dumani, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit Korporata Energjetike e Kosovës SH.A – Divizioni i Furnizimit, me seli në Gjakovë, kundër debitorit N.P.T. “F.Dardani” me pronar A.Sh., me seli në Rahovec, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Aktvendimit E.nr.806/2009 të datës 28.12.2009, të Gjykatës Themelore në Gjakovë – Dega në Rahovec, jashtë seancës, me datë 20.05.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

PRANOHET si i bazuar prapësimi i debitorit N.P.T. “F.Dardani”, dhe Aktvendimi E.nr.806/2009 të datës 28.12.2009, i Gjykatës Themelore në Gjakovë – Dega në Rahovec, SHFUQIZOHET.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Gjakovë – Dega në Rahovec, duke vepruar sipas propozimit për ekzekutim të kreditorit, me Aktvendim E.nr.806/2009 të datës 28.12.2009 ka lejuar përmbarimin mbi bazën e dokumentit – Fatura Nr. 80011938 të datës 06.12.2009, duke detyruar debitorin që në emër të borxhit t’ia paguaj kreditorit shumën e përgjithshme në vlerë prej 10,806.98€, në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të vendimit, duke llogaritur kumatën prej 3,5% nga dita e dorëzimit të propozimit në gjykatë deri në pagesën definitive, dhe shpenzimet e procedurës, ashtu që nëse debitori nuk e përmbush obligimin në afatin e përcaktuar atëherë lejohet realizimin i kërkesës nëpërmjet sekuestrimit të sendeve të luajtshme dhe me shitjen e tyre të bëhet inkasimi i borxhit në llogari të kreditorit.

Debitori me datë 12.03.2014 ka parashtruar kundërshtim ndaj Aktvendimit E.nr.806/2009 të datës 28.12.2009, duke theksuar se pretendimet e kreditorit janë të jo reale dhe të panjohura për

debitorin. Tutje ka shtuar se ka parashtruar ankesë pranë kreditorit pasi që kreditori nuk ka dorëzuar të dhëna të sakta se për cilët muaj është dhënë borxhi dhe cila është vlera e saktë e tij. Po ashtu ka theksuar se në kuptim të nenit 378 par.3 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve, kërkesa e kreditorit është vjetërsuar. Gjykatës i ka propozuar që të aprovohet kundërshtimi i tij dhe të anulohet aktvendimi për ekzekutim sipas propozimit për përmbarim.

Gjykata Themelore në Gjakovë – Dega në Rahovec ka marrë Aktvendim E.nr.806/2009 me datë 09.09.2015 me të cilën ka aprovuar pjesërisht prapësimin e debitorit të parashtruar kundër aktvendimit E.nr.806/2009 të datës 28.12.2009 lidhur me Faturën Nr. 80011938 të datës 06.12.2009 në vlerë prej 10,231.75€ me arsyetim të arritjes së parashkrimit. Ndërsa ka lënë në fuqi pjesën e aktvendimit E.nr.806/2009 të datës 28.12.2009 lidhur me shfrytëzimin e energjisë elektrike në vlerë prej 575.23€ duke përfshirë edhe shpenzimet e procedurës.

Kreditori me datë 09.11.2015 ka parashtruar ankesë ndaj aktvendimit E.nr.806/2009 të datës 28.12.2009 të Gjykatës Themelore në Gjakovë – Degës në Rahovec.

Gjykata e Apelit e Kosovës, me aktvendimin Ac.nr.1520/2016 të datës 14.04.2017, ka prishur Aktvendimin E.nr.806/2009 të datës 28.12.2009 të Gjykatës Themelore në Gjakovë – Degës në Rahovec dhe çështjen e ka kthyer rishqyrtim dhe rivendosje.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes në prapësim, vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, dhe vërejtjeve të dhëna sipas aktvendimit të Gjykatës së Apelit e Kosovës dhe duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, për shkaqet si në vijim:

Gjykata pas shqyrtimit të shkresave të lëndës gjeti se Propozimi për Përmbarim është lejuar në bazë të Faturës nr. 80011938 të datës 06.12.2009 për borxhin në vlerë prej 10,806.98€ dhe me Aktvendimin E.nr.806/2009 të datës 28.12.2009, të Gjykatës Themelore në Gjakovë – Dega në Rahovec është lejuar përmbarimi në bazë të nenit 23 dhe 30 të Ligjit nr. 03/L-008 për Procedurën Përmbarimore.

Në kuptim të nenit 398 të Ligjit nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, gjykata vendimin lidhur me prapësimin e morrin në kuptim të Ligjit nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore (LPP).

Sipas nenit 29 paragrafit 1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”* dhe me paragrafin 3 të njëjtit nen, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar “, ndërsa me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se “Kur propozimi për përmbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*

Gjykata duke u bazuar në të lartcekurat gjeti se dokumenti i besueshëm, Faturën Nr. 80011938 të datës 06.12.2009, në bazë të së cilës është lejuar propozimi për përmbarim nuk i plotëson kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm, për faktin se fatura në bazë të së cilës është mbështetur propozimi për përmbarim dhe është lejuar përmbarimi është bashkëngjitur në kopje (e printuar), ndërsa në shkresat e lëndës nuk është deponuar origjinali apo kopja e vërtetuar siç kërkohet me nenin 37 të LPP-së.

Në këtë drejtim, rezulton se propozimi për përmbarim mbi bazën e të cilit është lejuar urdhri, përmban të meta ngase në propozim nuk janë treguar dokumentet origjinale apo kopja e vërtetuar mbi bazën e të cilëve është iniciuar procedura përmbarimore, ashtu siç përcaktohet me dispozitën nga neni 38 paragrafi 1 i LPP-së: i cili përcakton se *“Propozimi për përmbarim duhet ta përmbajë kërkesën për përmbarim në të cilën do të tregohet dokumenti përmbarimor origjinal apo kopje e vërtetuar, apo dokumenti i besueshëm..”*.

Sipas nenit 43, par.4 të LPP-së përcaktohet se: *“...Në lidhje me ankesën që ngrehë kundërshtimin ndaj urdhrit të përmbarueshmërisë së nxjerrë nga përmbaruesi privat, Gjykata që kryen rishikimin e procedurës së përmbarimit rishikon nëse janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e atij urdhri nga përmbaruesi privat. Nëse Gjykata përcakton se nuk janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e urdhrit për përmbarim nga përmbaruesi privat, Gjykata shfuqizon urdhrin me vendim”*

Andaj, nga të lartcekurat gjykata vlerëson se në rastin konkret Aktvendimi mbi lejimin e përmbarimit E.nr.806/2009 të datës 28.12.2009, i Gjykatës Themelore në Gjakovë – Dega në Rahovec, është nxjerrë pa u plotësuar kushtet për lejimin e tij, ngase propozimit për përmbarim nuk i është bashkëngjitur origjinali apo kopja e vërtetuar e dokumentit të besueshëm dhe rrjedhimisht propozimi për përmbarim përmban të meta në kuptim të nenit 38 paragrafi 1 të LPP-së, të cilat në këtë fazë të procedurës nuk mund të evitohen nga gjykata, ngase në fazën e mjetit

juridik, gjykata kufizohet vetëm në shqyrtimin e përshtatshmërisë së dokumentit mbi bazën e së cilit është lejuar urdhri si dhe ligjshmërinë e urdhrit.

Meqenëse në rastin konkret, sipas vlerësimit të gjykatës nuk janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e urdhrit për përmbarim, ndërsa organi përmbarues - përmbaruesi privat, nuk ka vepruar konform nenit 38, paragrafi 2 të LPP-së, me të cilin përcaktohet se: *“Në rast se propozimi për përmbarim nga paragrafin 1. i këtij neni nuk përmbar shënimet e kërkuara dhe numrin personal identifikues apo numrin e regjistrimit të biznesit të debitorit, organi përmbarues do të veprojë sipas dispozitave të nenit 102 të Ligjit të Procedurës Kontestimore”*, gjykata shfuqizoi urdhrin përmbarimor dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Nga sa u tha më sipër, gjykata në mbështetje të nenit 398 lidhur me nenin 43 dhe 73 të LPP-së, si dhe nenit 13, paragrafi 1, pika 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.2154/23, datë 20.05.2024

Gjyqtari

Arnis Dumani

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.